



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 98 dt.30.07.1996

Këshillit Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.30.07.1996, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Propozim për kalim në fond banese”, në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992, neni.14 “Për organizimin e funksionimin e Pushtetit Lokal” , si dhe V.K.M. Nr.379, dt.26.06.1995 “Për disa shtesa e ndryshime”, në V.K.M. Nr.81, dt.28.02.1994 “Për kthimin në fond banese të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i Ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit”, pika.3

**VENDOSI**

1. Të kalojë në fond banesë provizor pa të drejtë privatizimi objekti ish repart i këpucarisë pranë N.P.V.U Tiranë për familjet që banojnë aty.
2. Të kalojnë në fond banese definitiv objekti godinë tre kate e ish shkollës së lirë Ushtarake pranë Kinostudios.
3. Të kalojnë në fond banese definitiv kati i tretë të godinës së ish hotelit të ushtarakëve Nr.2 që ndodhet pranë Ndërmarrjes Rruga Ura, në rrugën”M.Keta”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Seksioni i Strehimit të Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**